



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3010_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2769_10_25** i datës 15.10.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 27.11.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **E. G.**, nga Komuna e Ferizajt, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2769_10_25 i datës 15.10.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 15.10.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2769_10_25 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit E. G., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 0225155613DFE – 909082260 e dt. 06.02.2025 dhe korrigjimit financiar me nr. 152075DFE – 9082260 e dt. 19.03.2025, dhe e ka obliguar KESCO-në, që të anulojë korrigjimin financiar në vlerë prej -230.81€ dhe të bëjë korrigjimin të ri financiar në vlerë prej -939€, duke e bërë shpërndarjen e kWh për periudhën kohore 01/2023 – 12/2024.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Leximi i matësit dhe shpenzimet nuk janë vlerësuar plotësisht sipas gjendjes reale;
- Njehsori elektrik është ndërruar me datë 13.01.2025, por konsumatorit nuk i është bërë pranimi teknik sipas procedurës;
- Shpenzimet e ngarkuara nuk paraqesin shpenzim real mujor, por grumbullim nga periudha të mëhershme.
- Kërkon anulimin e tërësishëm të korrigjimit financiar në të gjitha periudhat ku ka pasur lexime të paqarta dhe të urdhërohet KESCO të bëjë llogaritje të re, sipas leximit real të matësit aktual, ditës së ndërrimit të matësit dhe periudha të dokumentuara saktë me prova teknike.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit, Procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik me nr. 0165742 i dt. 13.01.2025, Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0014433 e dt. 13.01.2025, Raportin Teknik mbi pranimin intern të KEDS me nr. 19946 i dt. 31.12.2024, Korrigjimin financiar të dt. 19.03.2025 si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Bordi i ka analizuar dy procesverbalet, procesverbalin e pranimit të instalimit elektrik nr.0165742 date 13.01.2025 dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0014433 date 13.01.2025 dhe konstaton se ekipet e KEDS-it kanë bërë pranimin e instalimit elektrik për njehsorin elektrik nr. 45243779 me gjendje të shpenzimeve TL=030012 kWh dhe TU=012175 kWh. Në procesverbalin e instalimit elektrik është evidentuar se konsumatori regjistrohet sipas PEE nr.10762 date 05.12.2023. Po të njëjtën ditë sipas procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0014433, vërtetohet se njehsori elektrik nr. 45243779 me gjendje të shpenzimeve TL=030012 kWh dhe TU=012175 kWh është larguar nga matja dhe është vendosur për matje njehsori nr.40171368 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, si dhe është evidentuar se bëhet ndërrimi sipas PEE. Bordi po ashtu konstaton se konsumatori ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik para regjistrimit, e që kjo është në kundërshtim me nenin 32 paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, ku thuhet se: *"Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë"*.

Sipas Raportit Teknik mbi Pranimin Intern të KEDS – Njësia për Pranime Teknike, me nr. 19946, i dt. 31.12.2024, vihet re që, për konsumatorin Atdhe Lohaj "SN-A" SHPK, lidhur me objektin 7 me 81 njësi banesore dhe lidhur me objektin 8 me 64 njësi banesore, me total 146 njësi, si dhe TS-i i ri, sipas PEE-së së dt. 05.12.2023, është konstatuar se, janë plotësuar kushtet për energjizim të objektit.

Sipas transaksioneve të konsumatorit vërtetohet se me datë 31.01.2025 konsumatori është faturuar me shërbime për lidhje të re si dhe i është hapur shifra DFE 9082260. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore por që vërtetohet se nga periudha 02/2025 e tutje konsumatori ka lexime dhe faturime të rregullta mujore.

Bordi e ka shqyrtuar faturën nr. 0225155613DFE-909082260 e datës 06.02.2025, krahasuar edhe me shpenzimet e konsumatorit konstaton se, ky faturim nuk paraqet shpenzim real mujor por që paraqet shpenzim të grumbulluar nga periudhat e mëhershme si rrjedhojë e kyçjes pa lejen e operatorit. Bordi ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar nr. 152075DFE-9082260 të datës 19.03.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej -230.81€, në të cilin është evidentuar si vijon: *"Shpërndarje e kWh për periudhën 01/2025 deri 02/2025 dhe faturimi i kWh për periudhën 07/12/2024"*



sipas raportimit të lexuesit si njehsor ilegal me datën 10.12.2024 A1=28055 kWh dhe A2=11155 kWh, ndërsa njehsori është regjistruar në muajin 02/2025, bazuar në procesverbalin e pranimit teknik me nr. 0165742 i datës 13.01.2025, A1=30012 kWh dhe A2=12175 kWh”, dhe ka gjetur se, ky korrigjim nuk është i saktë për shkak se shpenzimet e konsumatorit me njehsorin e ri nuk përputhen me shpërndarjen e bere nga KESCO për periudhën 6 mujore. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike me njehsorin e ri elektrik nr. 40171368 (periudha 02/2025 deri në periudhën 10/2025) shpenzimi mesatar mujorë është 1,154 kWh/muaj. Konsumatori po ashtu ka ofruar dy kontrata, një të ofruesin e shërbimeve Internet/TV të datës 27.09.2022-por që adresa nuk përputhet me vendbanimin si dhe një fature të shërbimit të kompanisë publike për furnizim me ujë të periudhës 10/2023 me të cilën vërtetohet se ka pasur borxhe të pa paguar në adresën e njëjtë për periudhë me të gjatë. DMK duke pasur parasysh shpenzimet e tanishme të konsumatorit si dhe faturimin për shërbime me Ujë-KRU “Bifurkacioni”, konstaton se konsumatori duhet të bëhet shpërndarja e kWh për periudhën 01/2023-12/2024 sipas raportimit të lexuesit date 10.12.2024 duke bere korrigjimin financiarë në vlerë 939€.

Tutje, DMK thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, “të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **E. G.**
- Arkivit të ZRRE-së